

V E N D I M
Nr. 20, datë 3.9.2000

PËR CAKTIMIN E SEKRETARËVE TË KZQV-SË.

Në mbështetje të nenit 153 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 18/1, 8 dhe të nenit 38/3 të ligjit nr 8609, datë 8.5.2000 për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Në të gjitha bashkitë dhe komunat ku nuk ka sekretarë të bashkisë dhe komunës, sekretar i KZQV së kësaj bashkie dhe komune do të emërohen nga KQZ me propozimin e KZQV përkatëse.
2. Sekretarët e emëruar, sipas pikës 1, të këtij vendimi kryejnë detyrat e sekretarit të KZQV, për aq sa parashikon Kodi Zgjedhor dhe nuk mund të kryejnë asnjë funksion si sekretar të Këshillave vendorë.
3. Pas daljes së këtij vendimi këshillat vendore zgjedhin sekretarin e tyre, ai kryen detyrën si sekretar i këshillit përkatës vendor, konform ligjës, por jo të sekretarit të KZQV.
4. Sekretarët e njësive bashkiake të qytetit të Tiranës emërohen nga KQZ me propozim të KZQV të njësive bashkiake të Tiranës.
5. Mbledhjen e parë të njësive bashkiake të Tiranës e thërret kryetari dhe nënkryetari i njësive bashkiake të Tiranës.
6. Ky vendim të shpallet në media si dhe të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE